

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Hapni arkivat për të zhdukurit" , Kurti i kërkon Serbisë të ndihmojë në gjetjen e të humburve gjatë luftës – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/hapni-arkivat-per-te-zhdukurit-kurti-i-kerkon-serbise-te-ndihm-oje-ne-gjetjen-e-te-humburve-gjate-luftes/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 05:13:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	30 gusht 2026, 11:44:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	407b033a736cdfa32010e313a9924c8065c3af369e3ba90322bc61407618392d
TEKSTI	330bb03a03e2797d29af9dd47539fff61dd0e647a2593490fde563c80275044b
PAMJA	edad912867bd20a352c301ebd933962c43185d3236ec13a30e686ebcdc0a9ff

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1a3adc2a67de769f2a09d101c2ff51421568434813d6e4439753c8d57c0db0a0
E MËPARSHMJA	e9bfe5dbfc6902336f86ce4ff2a6ca59a7fdbbecf5966f5f68e0b23fff476b1d
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1a3adc2a67de769f2a09d101c2ff51421568434813d6e4439753c8d57c0db0a0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, kërkoi nga Serbia hapjen e arkivave që mund të ndihmojnë në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës së Kosovës.

Kurti rikujtoi zotimin e Serbisë për bashkëpunim në këtë drejtim, duke vënë theksin te dosjet e Ushtrisë Jugosllave dhe veçanërisht te ato të Brigadës së Motorizuar 37, e cila, sipas tij, ka kryer masakra në Kosovë.

“Mos harrojmë edhe deklaratën e 2 majit të vitit 2023, me të cilën Serbia zotohet që do të bashkëpunojë për hapjen e arkivave në mënyrë që të zbardhet e vërteta. Më duhet ta ritheksoj që një ndër dosjet më të rëndësishme që të deklasifikohet është ajo e brigadës së motorizuar ushtarake të Ushtrisë Jugosllave 37, e cila ka kryer shumë masakra në Kosovë e posaçërisht në Drenicë”, tha Kurti.

Kurti tha se Kosova nuk mund të presë deri në vitin 2044, kur sipas afateve të klasifikimit pritet të hapen këto dokumente. Ai kërkoi njëkohësisht edhe trysni nga Bashkimi Evropian ndaj Beogradit, duke argumentuar se Serbia synon anëtarësimin në BE dhe përfiton fonde të konsiderueshme nga Unioni.

Kreu i ekzekutivit në detyrë e lidhi gjithashtu klasifikimin e dosjeve me vitin 2014, kur presidenti aktual i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ishte ministër i Mbrojtjes.

5 Elbasani nuk tan Egnatia person
humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

“Nuk mund të presim deri në vitin 2044 që të napolen keto arkiva. Ato do të duhej që të hapeshin që dje, që pardje. Ndërkohë që janë klasifikuar pikërisht në vitin 2014, atëherë kur presidenti aktual i Serbisë, Vuçiç, ishte ministër i Mbrojtjes dhe ishte gjithashtu dhe koordinatori i shërbimeve sekrete informative. Tash merreni me mend, ky që është presidenti i Serbisë sot, në vitin 2014 kur janë klasifikuar dosjet e Ushtrisë Jugosllave që kanë kryer krime në Kosovë, e në veçanti e brigadës së motorizuar 37, ka qenë ministri i Mbrojtjes dhe koordinatori i shërbimeve informative dhe sekrete të Serbisë”, u shpreh Albin Kurti.

Çështja e të pagjeturve mbetet një nga plagët më të rënda të luftës në Kosovë. Kurti tha se janë ende mbi 1 mijë e 500 persona të zhdukur, ndërsa familjet e tyre vijojnë të jetojnë mes ankthit dhe pasigurisë për fatin e të afërmeve.

Ndërkohë, operacionet e kërkimit vijojnë në veri të Kosovës. Në fshatin Kalludër të Vogël, në komunën e Zubin Potokut, institucionet vendore po kryejnë gërmime pas dyshimeve për ekzistencën e një varreze masive nga lufta. Deri tani, në zonë janë identifikuar disa vende me mbetje mortore.

#kosove #kurti #Serbi



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh

KOSOVA

Kosova me Qeveri të re! Kuvendi miraton...

Xhuljana Zhuleku Dje 17:49

KOSOVA

Pas konstituimit të Kuvendit, Albin Kurti...

Xhuljana Zhuleku Dje 15:26

KOSOVA

Kuvendi i Kosovës konstituohet pa PDK...

Xhuljana Zhuleku Dje 13:37



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.